

## **PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbim**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Mirembajtje e automjeteve”

**Marreveshje Kuadër - me një operatorë ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat të marrëveshjes 365 dite.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**  
79800000 - Vajra karburanti, Graso dhe lubrifikante, fenere, motore automjesh, frena dhe pjesë te frenave etj

#### **VLERA E FONDIT LIMIT:**

**2 416 000 (dy milion e katerqind e gjashtembedhjete mije) leke, pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti kontraktor Ndermarrja e Sherbimeve Publike Sarande ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

##### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

##### **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**  
Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit të kualifikimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës së përlogaritur/fondit limit të kontratës.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: 40% e fondit limit të MK

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar:

Pika 1 e nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

#### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, shërbime të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e shërbimeve të kryera, e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet, datë e përlloritur nga data e hapjes së ofertave.

Referuar nenit 55 pika 4 gërma a e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

---

#### **2.3.2.Licenca profesionale si me poshte:**

**Kategoria:** Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor

**Nenkatëgoria:** Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkio

**Kodi:** VII.3.B.1

**Lloji i kategorise:** Licence, grupi 3

VII.3.B.1/a Riparimi dhe mirembajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

VII.3.B.1/b Riparimi dhe mirembajtja e karrocërve, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

VII.3.B.1/c Riparimi dhe mirembajtja e impiantit elektrik, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

VII.3.B.1/d Riparimi dhe mirembajtja e gomave, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të mesipërme.

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

*Legjislacioni në fuqi për prokurimin Abjct I jep mundësinë autoriteteve kontraktore që të kërkojnë licenca profesionale për kryerjen e shërbimit Abjct kontrate, të lëshuara nga autoritete kompetente shtetërore, në mënyrë që të vërtetojnë se shërbimi , operatoti I plotëson kërkesat sipas të gjitha përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, duke patur parasysh karakteristikat specifike të tij.*

*Këto kritere janë vendosur që operatorët ekonomik të jenë të pajisur sipas ligjit me lejet dhe autorizimet përkatëse për tregëtimin e këtij shërbimi, në zbatim të vendim Nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”i ndryshuar.*

*Kriteret e vendosur në referencë të dispozitave të sipërcituar, përcaktojnë se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm, vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, dhe duhet të jetë i pajisur me licencat profesionale, të lëshuara nga autoritete kompetente shtetërore, që vërtetojnë pajtueshmërinë e ofertuesit me standardet e kërkuara në legjislacionin e sipërpërmendur. Pra konsiderohen si kritere*

**2.3.3.** Operatori ekonomik duhet të vërtetojë një punësim mesatar i të paktën 2 personash, duke përfshirë stafin e përhershëm dhe stafin menaxherial për periudhën Janar – Mars 2024. Për të vërtetuar këto kritere operatorët duhet të paraqesë: Vërtetim nga Administrata Tatimore për numrin e të siguruarve mujor; Formularet E-SIG 025 “Listepagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” të konfirmuara nga administrata tatimore

**Argumentimi :** *Argumentimi:* Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës etj..

2.3.4. Te këto në shërbim dhe të deklarojë piken (at) e shërbimeve e riparimeve të mjeteve brenda territorit të bashkisë Sarandë ku shtrin aktivitetin Ndermarja e Shërbimeve Sarandë, ose të këto kontrate noteriale në një afat kohor minimum 1 (një) vit me një servis të licensuar për këto punime, që ushtron aktivitetin brenda territorit të Bashkisë Sarandë.

**Argumentimi** : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Ndermarja e shërbimeve ka një aktivitet të përditshëm dhe makinat duhet të jenë gjithmone në gjendje pune për të shërbyer në çdo moment.

Difektet e ndryshme që mund të ndodhin mund të jenë shumë serioze të cilat mund të çojnë deri në bllokim të punës. Për këtë arsye, për ne është me shumë rëndësi koha e riparimit të defektit e cila lidhet dhe me distancën e njesisë së shërbimit që do të ketë Operatori Ekonomik.

Nga kjo procedurë ne nuk kemi përjashtuar ata operatore ekonomik që operojnë në distanca të largëta nga përcaktimi që kemi vendosur në DST, pasi për këtë, është vendosur kriteri për lidhjen e një kontrate bashkëpunimi me operatore ekonomik që shërbejnë në zonat e Bashkisë Sarandë.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit për mjetet në rastet e difekteve nga adresa e autoritetit kontraktor deri në servis, si dhe të pjesëve të këmbimit.

**Argumentimi** : Kjo kërkesë është vendosur bazuar në ligjin nr. 162/2020, Për prokurimin publik, mbi besueshmerinë, neni 76/3/ë, 77, dhe verifikimin e informacionit të paraqitur në tender, dhe nenin 78 të ligjit të sipërcituar, në rast të paraqitjes së informacionit dhe dokumentacionit me të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, si dhe besueshmerisë për realizimin e shërbimit të transportit

---

### ***Specifikimet teknike të procedurës “Mirembajtje automjetesh” Viti 2024***

#### ***1.Preventivi***

Në preventivin hartuar për realizimin e kësaj procedurë prokurimi përcaktohen ;

- a. Marka, modeli, tipi, viti I prodhimit , numri I shasise së automjetit, të dhëna të cilat, janë të domosdoshme, për të gjetur pjesën e këmbimit ,që do të zëvendësohet, shoqëruar gjithashtu me një fotografi të tij, për t’u patur me të qartë se për cilin mjet apo automjet bëhet fjalë
- b. Për mjetet stacionare është pasqyruar marka dhe modeli ,për të përcaktuar me lehtë pjesën e këmbimit motorike.

Në marrjen e zotërisë së këtyre automjeteve ,që do të mirëmbahen dhe shërbehen sipas kësaj kontrate:



**JCB 3cx Skrep me targa AGMT66 viti 2003 shasia SLP3CXTS3E09376681**



**MAN kamion me vinç me targa AA792UG viti 2000 shasia  
WMAT34ZZZ1M308039**



**ATP Daimler Chrysler 311CDI Sprinter me targa AA979TX viti 2001  
shasia WDB9036221R315902**



**Daimler Benz 814 kamion me targa AA695FR viti 1986 shasia  
WDB67401215266219**



**APV Mercedes benz tip kosh 408D me targa AB367HA viti  
1991 shasia WD86113181P152749**



**APV MAN Autobot E49 me targa SR6702B viti 1996 shasia  
WMAE490063L012351**



**Automjet per transport mallrash me mbulese Mercedes Benz Atego me targa AB047DB viti 2017  
shasia WDB96702110121010**



**APV Iveco tip kosh me targa AB407MM viti 2009 shasia  
ZCFC3576005787897**



**Mjetet qe zoteron Ndermarrja jone dhe qe do te mirembahen ne vend jane:**




**Betoniere ndertimi, 180 Lt, motorr 6.5 HP**



**Gjenerator rryme : tip “BLIZZER” me benzene BL  
5000.**

**Vendodhja e Ndermarrjes se Sherbimeve.**



## 2.Kategorite e punimeve

<b>Motori dhe sistemet e ftohjes e te lubrifikimit</b>	Testate
	Guarnicion testate ose set guarnicionesh
	Fasho pistona
	Pompe vaji

	Vaj motori
	Filter vaji
	Pulexho + rregjistrues
	Rrip faze
	Rrip motori
	Pompe uji
	Radiator uji
	Ventilator
	Termostat
	Antifreeze
	Tubacione uji
<b>Sistemi I ushqimit</b>	Pompe nafte
	Injektore
	Tubacione presioni
	Filter nafte
	Filter ajri
	Farfalle ajri
<b>Sistemi I nxjerrjes se gazeve</b>	Kolektori I shkarkimit te gazeve
	Turbine
	Marmite
	Katalit (adblue)
<b>Sistemi I transmentimit te levizjes</b>	Volant
	Kit freksioni(disk - spinxhidisk)
	Kushinete freksioni

	Pompe freksioni
	Alkool
	Vaj kambio diferenciali
	Kembe kambioje,motori
	Leve marshi
	Kavo e leves se marshit
	Set transmisioni
	Kushinete mesi
	Kryq transmisioni
	Semiaks
	Grusht semiaksi
	Gomina semiaksi
<b>Sistemi I frenimit</b>	Ferota te para
	Ferota te pasme(disqe frena mbrapa skrepi)
	Pompe frenash
	Disk frenash
	Nofulla ferrotash
<b>Sistemi I drejtimit dhe amortizimit</b>	Grup timoni hidraulik
	Vaj hidraulik
	Paralel
	Krahe paraleli
	Koke paraleli
	Koke mocoje
	Moco
	Kushinete mocoje

	Amortizatore
	Stabilizatore
	Susta
	Balestra
<b>Impianti elektrik</b>	Bateri
	Gjenerator(dinamo)
	Motorino
	Fenere
	Sinjale
	Llampa
	Celesa, sinjalizues etj
	Kandeleta
	Pakete elektrike komanda vinci
	Paketa elektronike
<b>Sistemi I kondicionimit te ajrit</b>	Kompresor kondicioneri
	Radiator kondicioneri
	Ventilator kondicioneri
	Mbushje me gaz
<b>Agregati sistemi I vincerit</b>	Pompe hidrauliku
	Vaj hidrauliku
	Permistopa vinçi
	Tubacione te presionit te larte
	Grasatim
<b>Karroceria dhe komforti</b>	Xham I perpare

	Kofano
	Parakolp
	Parafango
	Riparim sedilje mbushje dhe veshje
	Fshirese xhami
	Veshje me poliester koshi
	Saldime me oksigjen
	Pasqyre

### ***3.Pesha specifike e punimeve***

Per te dhene nje ide me te qarte, per pergatitjen e ofertes, me poshte po paraqesim nje table, ne te cilen eshte percaktuar pesha specifike, qe ze cdo mjet dhe automjet, ne lidhje me vleren limit te kontrates te shprehura ne perqindje;

	MIREMBAJTJE AUTOMJETE	Perqindja e shpenzimeve per mjet ne raport me vleren totale
	<b>JCB 3cx Skrep me targa AGMT66 viti 2003 shasia SLP3CXTS3E09376681</b>	31 %
	<b>MAN kamion me vinç me targa AA792UG viti 2000 shasia WMAT34ZZZ1M308039</b>	17%
	<b>ATP Daimler Chrysler 311CDI Sprinter me targa AA979TX viti 2001 shasia WDB9036221R315902</b>	10.3%
	<b>Daimler Benz 814 kamion me targa AA695FR viti 1986 shasia</b>	10.3%

<b>WDB67401215266219</b>	
<b>APV Mercedes benz tip kosh 408D me targa AB367HA viti 1991 shasia WD86113181P152749</b>	9.5%
<b>APV MAN Autobot E49 me targa AB320KB viti 1996 shasia WMAE490063L012351</b>	4.6%
<b>Automjet per transport mallrash me mbulese Mercedes Benz Atego me targa AB047DB viti 2017 shasia WDB96702110121010</b>	6.6%
<b>APV Iveco tip kosh me targa AB407MM viti 2009 shasia ZCFC3576005787897</b>	9.9%
<b>Betoniere ndertimi, 180 Lt, motorr 6.5 HP</b>	0.4%
<b>Gjenerator rryme : tip "BLIZZER" me benzene BL 5000.</b>	0.3%

#### ***4.Sqarime te nevojshme per operatorin ekonomik***

Shifrat e mesiperme, te tabelës se perqindjeve te punimeve, jane shifra orientuese per ofertuesin,me qellim qe ai te kuptoje se si duhet ta ndertoje oferten e tij,qe te permbushë sa me mire kerkesat, qe ne kemi per sherbime dhe mallra,por, devijime te vogla,te parendesishme,qe nuk shtremberojne thelbin e kontrates, qe ne duan te realizojme,do te jene te pranueshme.P.sh. ne qofte se nje ze punimesh ne table eshte 24% dhe operatori ekonomik ofron per kete ze punimesh 20 -25% ,kuptohet qe kjo shifer do te jete e pranueshme.

Operatori ekonomik ose ofertuesi,kur te paraqese oferten e tij,duhet te kete parasysh se, cdo ze punimesh ,qe do te kryhet,ne rastet kur do te kerkoje zevendesim te pjeseve te demtuara,eshte furnizim dhe vendosje e kesaj pjese,prandaj zeri i ***punetorise(hak pune)***,nuk do te paraqitet me vete ne preventiv.

Nga ana tjeter, operatorët ekonomike, qe do te marrin pjese ne konkurim, duhet t'a kene te qarte se,meqenese kemi te bejme me nje procedure konkurimi, qe do t'i paraprije nje ***marreveshjeje kuader, autoriteti kontraktor nuk eshte i detyruar te kryje cdo punim sipas zerave te preventivit.. Ne***

***cdo rast, autoriteti kontraktor do te paguaje operatorin ekonomik, per ato pune,sherbime,riparime, qe do te ndodhin faktikisht.***

***Operatori ekonomik,eshte I detyruar te kryeje cdo punim, qe do t'i kerkoje autoriteti kontraktor,brenda vleres limit per cdo ze qe operatori ekonomik, ka ofertuar.***

### ***5.Praktika e punimeve***

Ne cdo rast qe, autoriteti kontraktor, do te kete nevoje per sherbime,riparime,kontrolle, ne mjetet apo automjetet,do te njoftoje operatorin ekonomik ,I cili,nga ana e tij,eshte I detyruar te hartoje nje raport mbi gjendjen teknike te agregatit,defektit te ndodhur,aresyeve te mundshme te ndodhjes se tij, te shoqeruar me nje preventiv, te pjeseve te kembimit qe duhen zevendesuar dhe sherbimeve e riparimeve qe do te kryhen.Ne asnje rast, operatori ekonomik nuk duhet te ofertoje nje sherbim , ne vlere me te madhe se cmimi qe ka paraqitur ne oferten e konkurimit.

Kur ky raport, te miratohet nga A.K.,operatori ekonomik, mund te filloje pune per riparimin e defektit.

Ne perfundim te sherbimit, operatori ekonomik, duhet t'i paraqese A.K.,

situacionin e punimeve,faturen se bashku me nje certificate garancie lidhur me punimet e kryera dhe pjeset e kembimit te vendosura ,

Dokumentacioni qe do te shoqeroje cdo procedure riparimi do te jete si me poshte;

1. Aktin e konstatimit te difektit
2. Preventivi me zerat e punimeve
3. Fatura
4. Certifikata e garancice se punimeve me afat minimal 1(nje) vjecar
5. Proces verbal i kontrollit dhe pranimet te sherbimit

Pjeset e kembimit,lubrifikantet, apo cdo detal tjetër qe do te zevendesohet, ne mjet apo automjet, duhet te jene produkte cilesore,nga prodhues te njohur dhe me reputacion ne kete fushe,me qellim qe te garantojne nje punim normal dhe sa me jetegjate te mjetit dhe automjetit.

Operatori ekonomik, duhet gjithashtu te marre masa, qe te mos krijoje vonesa punimesh te pajustificuara, si p.sh., mossigurimi ne kohe I pjeseve te kembimit apo mungesa e veglave te domosdoshme te punes, sidomos ato per punime speciale.

Gjate kohes qe, mjeti apo automjeti,ndodhet ne piken e tij te servisit,operatori ekonomik, eshte pergjegjes per sigurine fizike te mjetit.



Më pas u vendos për këto çështje:

Vlefshmëria e ofertës 150 ditë.

Kriteret e vlerësimit: Është çmimi më i ulët i ofruar.

Afatet e ekzekutimit, janë 365 dite nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes kuadër.

Komisioni unanimitisht bëri miratimin e tyre dhe u vendos vazhdimi i mëtejshëm i proçedurave, në Sistemin Elektronik.

---

---